



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 171

Tiranë – E premte, 25 shtator 2020

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 116/2020 datë 17.9.2020	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin Doha të protokollit të Kiotos së Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, aderuar me ligjin nr. 9334, datë 16.12.2004.....	12149
Dekret i Presidentit nr. 11737, datë 22.9.2020	Për shpallje ligji.....	12153
Ligj nr. 117/2020 datë 17.9.2020	Për denoncimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 100/2017.....	12154
Dekret i Presidentit nr. 11738, datë 22.9.2020	Për shpallje ligji.....	12156
Vendim i Kuvendit nr. 54/2020, datë 24.9.2020	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.....	12156
Vendim i Kuvendit nr. 55/2020, datë 24.9.2020	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.....	12156
Dekret i Presidentit nr. 11706, datë 14.9.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	12156
Dekret i Presidentit nr. 11742, datë 24.9.2020	Për rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese “Vakancë e parakohshme” .....	12157

Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 31, datë 13.8.2020	Për deklarinimin për punësim të shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Zonës Shengen, anëtarëve të familjes të shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Zonës Shengen, që nuk janë shtetas të këtyre vendeve, shtetasve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shtetasve të Kosovës, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, si dhe shtetasve që punësohen në sektorë të ndryshëm, me qëllim rregullimin e pasojave dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësi natyrore.....	12158
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 36, datë 21.9.2020	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.....	12162
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 14.9.2020	Për procedurën teknike për kryerjen e pagesës në rastet e kalimit të pasurive të paluajtshme.....	12162
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 146, datë 10.9.2020	Mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw, dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw.....	12164
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 147, datë 10.9.2020	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2020.....	12166
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 148, datë 10.9.2020	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat për dhënien e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror.....	12167
Vendim i Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 3, datë 18.3.2020	Për deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara “Sekret shtetëror” .....	12168
	Korrigjim gabimi material në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 298, datë 10.9.2020 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 165, datë 15.9.2020.....	12169
	Korrigjim gabimi material në kërkesën për shpronësim për interes publik të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5895/8, datë 11.9.2020, “Për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksioni i rrugës të brendshme të Kalasë së Ali Pashë Tepelenës dhe vazhdimi i shëtitores përgjatë hyrjes së Kalasë së Ali Pashë Tepelenës”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 163, datë 11.9.2020.....	12170



**LIGJ**  
**Nr. 116/2020**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AMENDAMENTIN DOHA TË PROTOKOLLIT TË KIOTOS SË KONVENTËS KUADËR TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE, ADERUAR ME LIGJIN NR. 9334, DATË 16.12.2004**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Republika e Shqipërisë aderon në amendamentin Doha të protokollit të Kiotos së Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për

ndryshimet klimatike, aderuar me ligjin nr. 9334, datë 16.12.2004, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.9.2020.

**Shpallur me dekretin nr. 11737, datë 22.9.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**

**AMENDAMENTI I DOHËS**  
**I PROTOKOLLIT TË KIOTOS**

**Neni 1: Amendamenti**

**A. Shtojca B e Protokollit të Kiotos**

Tabela e mëposhtme do të zëvendësojë tabelën e shtojcës B të protokollit:

1	2	3	4	5	6
<i>Pala</i>	<i>Kuifiziimi i emetimit sasior ose angazhimit reduktues (2008-2012) (përqindja e vitit apo periudhës bazë)</i>	<i>Kuifiziimi i emetimit sasior ose angazhimit reduktues (2013-2020) (përqindja e vitit apo periudhës bazë)</i>	<i>Viti i referencës<sup>1</sup></i>	<i>Kuifiziimi i emetimit sasior ose angazhimit reduktues (2013-2020) (shprehur si përqindje e vitit të referencës)<sup>1</sup></i>	<i>Zotimet për uljen e gazit serë deri në vitin 2020)<sup>2</sup></i>
Australia	108	99.5	2000	98	-5 deri në -15% ose -25% <sup>3</sup>
Austria	92	80 <sup>4</sup>		NZ	
Bjellorusia <sup>5</sup>		88	1990	NZ	-8%
Belgjika	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Bullgaria*	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Kroacia*	95	80 <sup>6</sup>	NZ	NZ	-20%/-30% <sup>7</sup>
Qipro		80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Republika Çeke*	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Danimarka	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Estonia*	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Bashkimi Evropian	92	80 <sup>4</sup>	1990	NZ	-20%/-30% <sup>7</sup>
Finlanda	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Franca	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Gjermania	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Greçia	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Hungaria*	94	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Islanda	110	80 <sup>8</sup>	NZ	NZ	



Irlanda	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Italia	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Kazakistani*		95	1990	95	-7%
Letonia*	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Lihtenshtejni	92	84	1990	84	-20%/-30% <sup>9</sup>
Lituania*	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Luksemburgu	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Malta		80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Monako	92	78	1990	78	-30%
Holanda	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Norvegjia	101	84	1990	84	-30%deri në -40% <sup>10</sup>
Polonia*	94	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Portugalia	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Rumania*	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Slovakia*	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Slovenia*	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Spanja	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
Suedia	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	-20% deri në
Zvicra	92	84.2	1990	NZ	-30% <sup>11</sup>
Ukraina*	100	76 <sup>12</sup>	1990	NZ	-20%
Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut	92	80 <sup>4</sup>	NZ	NZ	
<i>Pala</i>					
		<i>Kufizimi i emetimit sasior ose angazhimit reduktues (2008- 2012) (përqindja e vitet apo periudhës bazë)</i>			
Kanada <sup>13</sup>	94				
Japonia <sup>14</sup>	94				
Zelanda e Re <sup>15</sup>	100				
Federata Ruse <sup>16*</sup>	100				

*Shkurtim:* NZ=nuk zbatohet.

\* Shtetet që janë duke kaluar procesin e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut.

Të gjitha shënimet në fund të faqes, përveç shënimeve 1, 2 dhe 5, janë siguruar përmes komunikimeve nga palët përkatëse.

1. Një vit referues mund të përdoret nga një Palë mbi një bazë opsionale për qëllimet e veta për të shprehur kufizimin e sasisë së emetimit të tij ose angazhimin e zvogëlimit (QELRC) si përqindje e emetimeve të atij viti, që nuk është detyrues ndërkombëtarisht sipas Protokollit të Kiotos, përveç renditjes së QELRC (-eve) të saj, në lidhje me vitin bazë në kolonat e dyta dhe të treta të kësaj table, të cilat janë ligjërish të detyrueshme në nivel ndërkombëtar.

2. Informacione të mëtejshme mbi këto zotime mund të gjenden në dokumentet FCCC /SB/2011/INF.1/Rev.1 dhe FCCC /KP /AWG /2012/MISC.1, Add.1 dhe Add.2.

3. QELRC i Australisë sipas periudhës së dytë të angazhimit të Protokollit të Kiotos është në përputhje me arritjen e objektivit të pakushtëzuar të Australisë për vitin 2020 prej 5 për qind nën nivelet e vitit 2000. Australia mban opsionin më vonë për të lëvizur lart brenda objektivit të saj për vitin 2020 nga 5 në 15, ose 25 për qind nën nivelet e vitit 2000, në varësi të kushteve të caktuara që janë përmbushur. Kjo referencë mban statusin e këtyre zotimeve të bëra sipas Marrëveshjeve të Kankun dhe nuk përbën një angazhim të ri ligjor detyrues sipas këtij Protokollit ose rregullave dhe mënyrave të tij të lidhura.



4. QELRC për Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare të tij për një periudhë të dytë angazhimi sipas Protokollit të Kiotos bazohen në të kuptuarit që këto do të përmbushen së bashku me Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare të tij, në përputhje me nenin 4 të Protokollit të Kiotos. QELRC nuk paragjykon njoftimin pasues nga Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare të tij të një marrëveshje për të përmbushur angazhimet e tyre së bashku në përputhje me dispozitat e Protokollit të Kiotos.

5. Shtuar në shtojcën B me një ndryshim të miratuar në bazë të vendimit 10/CMP.2. Ky amendim nuk ka hyrë ende në fuqi.

6. QELRC e Kroacisë për një periudhë të dytë të angazhimit sipas Protokollit të Kiotos bazohet në të kuptuarit se do ta përmbushë këtë QELRC së bashku me Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare të tij, në përputhje me nenin 4 të Protokollit të Kiotos. Si pasojë, pranimi i Kroacisë në Bashkimin Evropian nuk do të ndikojë në pjesëmarrjen e saj në një marrëveshje të tillë të përbashkët përmbushjeje, në përputhje me nenin 4 ose QELRC të saj.

7. Si pjesë e një marrëveshje globale dhe gjithëpërfshirëse për periudhën pas vitit 2012, Bashkimi Evropian përsërit ofertën e tij të kushtëzuar për të kaluar në një ulje prej 30 për qind deri në vitin 2020 në krahasim me nivelet e vitit 1990, me kusht që vendet e tjera të zhvilluara të angazhohen për ulje të krahasueshme të emetimeve dhe vendet në zhvillim të kontribuojnë në mënyrë adekuate, sipas përgjegjësive të tyre dhe aftësive përkatëse.

8. QELRC për Islandën për një periudhë të dytë të angazhimit sipas Protokollit të Kiotos bazohet në të kuptuarit se do ta përmbushë këtë QELRC së bashku me Bashkimin Evropian dhe shtetet anëtare të tij, në përputhje me nenin 4 të Protokollit të Kiotos.

9. QELRC e paraqitur në kolonën tre i referohet një objektivit ulje prej 20 për qind deri në vitin 2020 në krahasim me nivelet e vitit 1990. Lihtenshtejni do të konsideronte një synim më të lartë uljeje deri në 30 për qind deri në vitin 2020 në krahasim me nivelet e vitit 1990 nën kushtin që vendet e tjera të zhvilluara të angazhohen për ulje të krahasueshme të emetimeve dhe që vendet në zhvillim më të përparuara ekonomikisht të

kontribuojnë në mënyrë të duhur në bazë të përgjegjësive të tyre dhe aftësive përkatëse.

10. QELRC i Norvegjisë prej 84 është në përputhje me objektivin e tij të uljes së 30 për qind të emetimeve deri në vitin 2020, në krahasim me vitin 1990. Nëse mund të kontribuojë në një marrëveshje globale dhe gjithëpërfshirëse ku palët kryesore emetuese bien dakord për uljen e emetimeve në përputhje me objektivin 2°C, Norvegjia do të kalojë në një nivel prej 40 për qind ulje për vitin 2020 bazuar në nivelet e vitit 1990. Kjo referencë mban statusin e zotimit të bërë sipas Marrëveshjeve të Kankunit dhe nuk përbën një angazhim të ri ligjërishit detyruës sipas këtij Protokollit.

11. QELRC e paraqitur në kolonën e tretë të kësaj table i referohet një objektivit zvogëlues prej 20 për qind deri në vitin 2020 në krahasim me nivelet e vitit 1990. Zvicra do të konsideronte një objektiv ulje më të lartë deri në 30 për qind deri në vitin 2020 në krahasim me nivelet e vitit 1990 subjekt i angazhimeve të krahasueshme të uljes së emetimeve nga vendet e tjera të zhvilluara dhe kontributi i duhur nga vendet në zhvillim sipas përgjegjësive dhe aftësive të tyre në përputhje me objektivin 2°C. Kjo referencë mban statusin e këtyre zotimeve të bëra sipas Marrëveshjeve të Kankunit dhe nuk përbën një angazhim të ri ligjor detyruës sipas këtij Protokollit ose rregullave dhe mënyrave të tij të lidhura.

12. Duhet të jetë bartës i plotë dhe nuk ka pranim të ndonjë anulimi ose kufizimi në përdorimin e kësaj prone sovrane të fituar në mënyrë të ligjshme.

13. Më 15 dhjetor 2011, Depozitari pranoi njoftimin me shkrim për tërheqjen e Kanadasë nga Protokollit i Kiotos. Ky veprim do të hyjë në fuqi për Kanadanë në 15 dhjetor 2012.

14. Në një komunikim të datës 10 dhjetor 2010, Japonia tregoi se nuk ka ndonjë qëllim të jetë nën detyrimin e periudhës së dytë të angazhimit të Protokollit të Kiotos pas vitit 2012.

15. Zelanda e Re mbetet Palë në Protokollin e Kiotos. Do të marrë një objektiv për uljen sasior të emetimit të ekonomisë së gjerë sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike për periudhën 2013 deri më 2020.

16. Në një komunikim të datës 8 dhjetor 2010 që u pranua nga sekretariati më 9 dhjetor 2010, Federata Ruse tregoi se nuk synon të marrë një



angazhim për kufizimin dhe reduktimin e sasisë të emetimeve për periudhën e dytë të angazhimit.

### B. Shtojca A e Protokollit të Kiotos

Lista e mëposhtme zëvendëson listën nën titullin “Gazet serë” në shtojcën A të Protokollit:

#### Gazet serë

Dioksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>)  
Metani (CH<sub>4</sub>)  
Oksidi i azotit (N<sub>2</sub>O)  
Hidrofluorokarbure (HFCs)  
Perfluorokarbure (PFCs)  
Heksafluoridi i squfurit (SF<sub>6</sub>)  
Trifluoridi i azotit (NF<sub>3</sub>)<sup>1</sup>

### C. Neni 3, paragrafi 1 bis

Paragrafi vijues do të shtohet pas paragrafit 1 të nenit 3 të Protokollit:

1 bis. Palët e përfshira në shtojcën I individualisht ose bashkërisht do të sigurojnë që emetimet ekuivalente të agregateve antropogjenike të dyoksidit të karbonit të gazeve të serës të listuara në shtojcën A nuk do të kalojnë sasinë e tyre të caktuar, të llogaritura në përputhje me kufizimet sasiore të emetimeve dhe angazhimet e reduktimit të shënuara në kolonën e tretë të tabelës të përfshirë në shtojcën B dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni, me qëllim zvogëlimin e emetimeve të përgjithshme të këtyre gazrave me të paktën 18 për qind në nivelet e vitit 1990 në periudhën e angazhimit 2013–2020.

### D. Neni 3, paragrafi 1 ter

Paragrafi vijues do të shtohet pas paragrafit 1 bis të nenit 3 të Protokollit:

1 ter. Një Palë e përfshirë në shtojcën B mund të propozojë një rregullim për të ulur përqindjen e shënuar në kolonën e tretë të shtojcës B të kufizimit sasiore të emetimit dhe angazhimit të reduktimit, të shënuar në kolonën e tretë të tabelës, të përfshirë në shtojcën B. Një propozim për një rregullim të tillë do t'i komunikohet Palëve nga sekretari të paktën tre muaj përpara mbledhjes së Konferencës së Palëve që shërben si takimi i Palëve

të këtij Protokollit në të cilin propozohet për miratim.

### E. Neni 3, paragrafi 1 quater

Paragrafi vijues do të shtohet pas paragrafit 1 ter të nenit 3 të Protokollit:

1 quater. Një rregullim i propozuar nga një Palë e përfshirë në shtojcën I për të rritur ambicien e kufizimit sasiore të emetimit dhe angazhimit të reduktimit në përputhje me nenin 3, paragrafi 1 ter, më lart do të konsiderohet i miratuar nga Konferenca e Palëve që shërben si mbledhja e Palëve të këtij Protokollit, përveç nëse më shumë se tre të katërtat e Palëve janë të pranishëm dhe janë objekt votimi për miratimin e tij. Rregullimi i miratuar do t'i komunikohet nga sekretari Depozituesit, i cili do t'ua shpërndajë atë të gjitha palëve, dhe do të hyjë në fuqi më 1 janar të vitit pas komunikimit nga Depozituesi. Rregullimet e tilla do të jenë detyruese për Palët.

### F. Neni 3, paragrafi 7 bis

Paragrafët e mëposhtëm do të shtohen pas paragrafit 7 të nenit 3 të Protokollit:

7 bis. Në periudhën e dytë të angazhimit për kufizimin dhe reduktimin sasiore të emetimeve nga viti 2013 deri në vitin 2020, sasia e paracaktuar për secilën Palë të përfshirë në aneksin I duhet të jetë e barabartë me përqindjen përkatëse të shënuar në kolonën e tretë të tabelës të përfshirë në aneksin B të emetimeve ekuivalente të agregatëve antropogjenikë të dioksidit të karbonit të gazeve serrë të listuara në aneksin A në vitin 1990, ose me vitin apo periudhën bazë të përcaktuar në përputhje me paragrafin 5 më lart, shumëzuar me tetë. Këto palë të përfshira në aneksin I për të cilat ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet përbënte një burim neto të emetimit të gazeve serrës në vitin 1990, duhet të përfshijnë në vitin apo periudhën bazë të emetimeve të vitit 1990 emetimet ekuivalente të agregatëve antropogjenikë të dyoksidit të karbonit nga burimet minus heqjet nga derdhjet në vitin 1990 nga ndryshimi i përdorimit të tokës, me qëllim përlllogaritjen e sasisë së caktuar.

### G. Neni 3, paragrafi 7 ter

Paragrafi i mëposhtëm do të shtohet pas paragrafit 7 bis të nenit 3 të Protokollit:

<sup>1</sup> Zbatohet vetëm nga fillimi i periudhës së dytë të angazhimit.



7 ter. Çdo diferencë pozitive midis sasisë së paracaktuar të periudhës së dytë të angazhimit për një Palë të përfshirë në aneksin I dhe emëtimet mesatare vjetore për tre vitet e para të vazhdimit të periudhës së angazhimit shumëzuar me tetë duhet të transferohen në llogarinë e anulimit të asaj Pale.

#### H. Neni 3, paragrafi 8

Në paragrafin 8 të nenit 3 të Protokollit, fjalët: përllogaritje, përmendur në paragrafin 7 më sipër

do të zëvendësohen nga:

përllogaritjet, përmendur në paragrafin 7 dhe 7 bis më sipër.

#### I. Neni 3, paragrafi 8 bis

Paragrafi i mëposhtëm do të shtohet pas paragrafit 8 të nenit 3 të Protokollit:

8.bis Çdo Palë e përfshirë në aneksin I mund të përdorë vitin 1995 ose 200 si vitin bazë për tri fluoridin e azotit me qëllim përllogaritjen e përmendur në paragrafin 7 bis më sipër.

#### J. Neni 3, paragrafi 12 bis dhe ter

Paragrafët e mëposhtëm do të shtohen pas paragrafit 12 të nenit 3 të Protokollit:

12 bis. Çdo njësi e krijuar nga mekanizmat e bazuar në treg që do të themelohet në bazë të Konventës ose instrumenteve të saj mund të përdoret nga Palët e përfshira në aneksin I për t'i ndihmuar ato në arritjen e pajtueshmërisë në angazhimin për kufizimin dhe reduktimin sasior të emëtimeve të tyre sipas nenit 3. Çdo njësi e tillë të cilën një Palë merr nga një Palë tjetër e Konventës, i shtohet sasisë së paracaktuar për Palën marrëse dhe zbritet nga sasia e njësive të mbajtura nga Pala transferuese.

12 ter. Konferenca e Palëve që shërben si takimi i Palëve të këtij Protokollit duhet të sigurojë që, kur njësitë nga aktivitetet e miratuara në bazë të mekanizmave të bazuara në treg, të përmendura në paragrafin 12 bis më sipër, përdoren nga Palët e përfshira në aneksin I t'i ndihmojnë ato në arritjen e pajtueshmërisë në angazhimin për kufizimin dhe reduktimin sasior të emëtimeve të tyre sipas nenit 3, një pjesë e këtyre njësive përdoret për të mbuluar shpenzimet administrative, si dhe për të ndihmuar Palët e vendeve në zhvillim që janë veçanërisht të ndjeshme ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimit

të klimës për të përmbushur kostot e përshtatjes nëse këto njësi janë marrë në bazë të nenit 17.

#### K. Neni 4, paragrafi 2

Fjalët e mëposhtme do të shtohen në fund të fjalisë së parë të paragrafit 2 të nenit 4 të Protokollit:

, ose në datën e depozitimit të instrumenteve të tyre të pranimit të çdo ndryshimi në aneksin B, në përputhje me nenin 3, paragrafi 9

#### L. Neni 4, paragrafi 3

Në paragrafin 3 të nenit 4 të Protokollit, fjalët: , paragrafi 7

do të zëvendësohen nga:  
fjalët me të cilat ka lidhje.

#### Neni 2: Hyrja në fuqi

Ky ndryshim hyn në fuqi në përputhje me nenin 20 dhe 21 të Protokollit të Kiotos

### DEKRET

Nr. 11737, datë 22.9.2020

### PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

### DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 116/2020 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin Doha të Protokollit të Kiotos së Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, aderuar me ligjin nr. 9334, datë 16.12.2004”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Ilir Meta**

**LIGJ**  
**Nr. 117/2020****PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES  
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE FONDIT SAUDIT  
PËR ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E  
PROJEKTIT “REHABILITIMI I RRUGËS  
SË LUMIT TË VLORËS”, RATIFIKUAR  
ME LIGJIN NR. 100/2017**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pikat 1 dhe 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**  
Neni 1

Denoncohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për

**Numri i referencës:** 22304  
**Data:** 22.4.2020  
**Bashkëlidhur**.....

Zhvillim për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 100/2017.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.9.2020.

**Shpallur me dekretin nr. 11738, datë 22.9.2020**  
**të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Ilir Meta**

**SFD**  
Fondi Saudit për Zhvillim

**MESAZH ME FAKS**

**Drejtuar:** SH.T. Ministrit të Financave dhe Ekonomisë  
Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Republika e Shqipërisë

**Numri i faksit:** (+35542228405)

**LËNDA:** Përfundimi/Zgjidhja e Marrëveshjes së Huas me Fondin Saudit për Zhvillim nr. 03/693 (Projekti për Rehabilitimin e Rrugës së Lumit të Vlorës)

**Bashkëlidhur**

**KOMENTE**

**PËRGATITUR NGA** /Nënskrimi/

**MIRATUAR NGA** /Nënskrimi/





Numri i referencës: 22304  
Data: 22/4/2020  
Bashkëlidhur.....

SFD  
Fondi Saudit për Zhvillim

Drejtuar: SH.T. Ministrit të Financave dhe Ekonomisë  
Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Republika e Shqipërisë

Numri i faksit: (+35542228405)

Lënda: Përfundimi/Zgjidhja e Marrëveshjes së Huas me Fondin Saudit për Zhvillim  
nr. 03/693 (Projekti për Rehabilitimin e Rrugës së Lumit të Vlorës)

Shkëlqesia Juaj,

Në vijim të letrës së Shkëlqesisë suaj, nr. 3132, datë 21.2.2020, në lidhje me objektin e mësipërm, shpreh kënaqësinë t'ju informoj se pranojmë të përfundojmë/zgjidhim Marrëveshjen e Huas së lartpërmendur, me vendimin e bordit nr.: 2380/125/9. Në këtë mënyrë, Marrëveshja e Huas ndërpritet që prej datës 29.12.2019.

Përshëndetjet më të mira,

Me respekt,

**Khalid S. ALKhudairy**  
Zëvendëskryetar dhe Drejtor i Përgjithshëm  
*/Nënshkrimi/*

+966 11 4647450 +966 11 279 4000  
P.O Box 50483- Riyadh 11523- Kingdom of Saudi Arabia- Tel+966 11 279 4000 Faks:+966 11 4647450 [www.sfd.gov.sa](http://www.sfd.gov.sa)



**DEKRET**  
Nr. 11738, datë 22.9.2020

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Shpalljen e ligjit nr. 117/2020 “Për denoncimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit ‘Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës’”, ratifikuar me ligjin nr. 100/2017.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË**  
**Ilir Meta**

**VENDIM**  
Nr. 54/2020

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË  
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR  
SHKARKIMIN E MINISTRIT TË  
ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

Në mbështetje të nenit 98, të Kushtetutës, dhe të dekretit nr. 11731, datë 17.9.2020, të Presidentit të Republikës,

**KUVENDI**  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**VENDOSI:**

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11731, datë 17.9.2020, për shkarkimin e zonjës Besa Shahini nga detyra e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 24.9.2020.

**VENDIM**  
Nr. 55/2020

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË  
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR  
EMËRIMIN E MINISTRIT TË ARSIMIT,  
SPORTIT DHE RINISË**

Në mbështetje të nenit 98, të Kushtetutës, dhe të dekretit nr. 11732, datë 17.9.2020, të Presidentit të Republikës,

**KUVENDI**  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**VENDOSI:**

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11732, datë 17.9.2020, për emërimin e zonjës Evis Kushi në detyrën e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 24.9.2020.

**DEKRET**  
Nr. 11706, datë 14.9.2020

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, me propozim edhe të Ministrisë së Brendshme,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. John Terry Francis Aimone
2. Ervala Bashkim (Baskim) Koca
3. Omar Mohamed (Mohammed) Faraj (Farag) Khalleefah (Khalleefah)



4. Pelin Erdoğan Yurtsever (Çulha)
5. Arton Sali Kelmendi
6. Egzana Sejfedin Kelmendi (Mehi)
7. Ema Arton Kelmendi
8. Elsa Arton Kelmendi
9. Elion Arton Kelmendi
10. Njomëza Hadi Rexhepi
11. Zahrie Ramadan Podrimqaku Subashi  
(Podrimqaku)
12. Selvete Nijazi Shuleta Qehaja (Shuleta)
13. Bahtije Sadri Maliqi (Zejnuli)
14. Azem Muharrem Mrasori
15. Arif Mersel Morina
16. Sami Arif Morina
17. Elhame Enver Sekirapa
18. Vegim Ali Mahmutaj
19. Carlo Giuseppe Pellicano
20. Meryem Halil Yanar (Özcan)
21. Faruk Avdyl Haxhiu
22. Majlinda Shaban Gota (Shala)
23. Sadije Xhafer Shehu (Hona)
24. Ümüt Sami Sevim
25. Samedia Shefki Memed
26. Annelise Maurilio Missori
27. Yilmaz Çağatay Ali Şahin
28. Güney Berkay Ali Şahin
29. Ardit Zenun Zenunaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Ilir Meta**

**DEKRET**  
Nr. 11742, datë 24.9.2020

**PËR RISHPALLJEN E THIRRJES PËR  
PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR  
PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT  
GJYQATAR NË GJYKATËN  
KUSHTETUESE “VAKANCË  
E PARAKOHSHME”**

Në mbështetje të neneve 93, 125, 127, pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179, pika 2, të Kushtetutës, neneve 7, pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh, pika 2, 86, pika 4, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi vlerësova njoftimin nr. 268 prot., datë 18.9.2020 dhe vendimin nr. 29, datë 16.9.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, administruar me nr. 3188 prot., datë 21.9.2020, nëpërmjet të cilit KED-ja ka vendosur njoftimin e Presidentit të Republikës për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme e shpallur fillimisht nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 10723, datë 7.2.2018, rishpallur me dekretin nr. 11291, datë 27.9.2019, për shkak se në përfundim të procedurave të verifikimit të ndjekura nga KED-ja, rezultoi se në garë për plotësimin e këtij vendi vakant, aktualisht nuk ka kandidatë të kualifikuar me vendim të formës së prerë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Rishpalljen e procedurës së aplikimit për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e “Vakancës së parakohshme” të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit të ish-gjyqtarit Besnik Imeraj.

Neni 2

Rishpallja e kësaj procedure aplikimi dhe publikimi i saj, sipas tekstit bashkëlidhur të bëhet menjëherë në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Ilir Meta**



## UDHËZIM

Nr. 31, datë 13.8.2020

**PËR DEKLARIMIN PËR PUNËSIM TË  
SHTETASVE TË VENDEVE TË  
BASHKIMIT EVROPIAN DHE ZONËS  
SHENGEN, ANËTARËVE TË FAMILJES  
TË SHTETASVE TË VENDEVE TË  
BASHKIMIT EVROPIAN DHE ZONËS  
SHENGEN, QË NUK JANË SHTETAS TË  
KËTYRE VENDEVE, SHTETASVE TË  
SHTETEVE TË BASHKUARA TË  
AMERIKËS, SHTETASVE TË KOSOVËS,  
BOSNJË-HERCEGOVINËS, MALIT TË ZI,  
SERBISË DHE MAQEDONISË SË  
VERIUT, SI DHE SHTETASVE QË  
PUNËSOHEN NË SEKTORË TË  
NDRYSHËM ME QËLLIM  
RREGULLIMIN E PASOJAVE DHE  
RIMËKËMBJEN NGA FATKEQËSI  
NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 71, 72 dhe 147 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, si dhe nenit 10 të ligjit nr.13/2020, datë 12.02.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, ‘Për të huajt’”, i ndryshuar

## UDHËZOJ:

1. Shtetasit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Zonës Shengen, anëtarët e familjes të shtetasve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Zonës Shengen që nuk janë shtetas të këtyre vendeve, shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shtetasit e Kosovës, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, si dhe shtetasit që punësohen në sektorë të ndryshëm me qëllim rregullimin e pasojave dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësi natyrore, deklarimi për punësimin e të cilëve bëhet nga punëdhënësi ose vetë i huaji i vetëpunësuar apo investitor, në zyrën e punësimit në vendin ku kryhet aktiviteti, të pajisen me dokument që vërteton deklarimin e tyre për punësim.

2. Punëdhënësi ose i huaji i vetëpunësuar apo investitor të aplikojë on-line në portalin e-Albania, duke plotësuar formularin “Kërkesë për vërtetim

deklarimi për punësim”, dhe bashkëlidhur me të dokumentacionin e poshtëshënuar:

- a) pasaportë ose dokument identifikimi (kopje);
- b) certifikatë familjare, ose dokument që vërteton marrëdhënien familjare, për anëtarët e familjes së shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Zonës Shengen që nuk kanë shtetësinë e këtyre vendeve;
- c) kontratë qiraje (kopje) ose vetëdeklarim për adresën e banimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të shtetasit të huaj;
- d) kontratë pune me punëdhënësin për llogari të të cilit kryen aktivitetin e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë për të punësuarit, ose statusin dhe aktin e themelimit (për shoqëritë) ose vërtetim regjistrimi në QKB (për personat fizikë) për të huajt e vetëpunësuar, ose statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, ku në përmbajtje të rezultojë se investitori bën një investim për investitorët.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni i përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, i drejtohet zyrës përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës subjekti pranë të cilit do të transferohet ushtron veprimtarinë ekonomike, dhe në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në nivel qendror, nëse subjekti pranë të cilit do të punojë shtetasi i huaj, e ushtron veprimtarinë ekonomike në më shumë se një rajon gjeografik.

4. Zyrtari përkatës, në rast dyshimi mbi të dhënat dhe dokumentacionin e paraqitur, të përcjellë këtë informacion tek strukturat e Ministrisë së Brendshme.

5. Pajisja e të huajt me vërtetimin e deklarimit për punësim, të bëhet nga zyra përkatëse e punësimit ku i huaji ushtron aktivitetin e tij, në një afat kohor prej 5 ditë pune që nga dita e aplikimit.

6. Formulari i kërkesës për Vërtetimin e Deklarimit për Punësim dhe Formatin e Vërtetimit të Deklarimit për Punësim, është pjesë e këtij udhëzimi.

7. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij udhëzimi.

8. Urdhri nr. 70, datë 23.2.2018 “Për deklarimin për punësim të shtetasve të Bashkimit Evropian, Zonës Shengen, shtetasve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shtetasve të Republikës së Kosovës dhe shtetasve të Republikës së Serbisë të përkatësisë etnike shqiptare”, dhe udhëzimi nr. 25, datë 9.9.2019 “Për deklarimin për punësim të



shtetasve të Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut të përkatësisë etnike shqiptare”, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE  
EKONOMISË  
**Anila Denaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

Nr. \_\_\_\_ prot.                   Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

**DREJTUAR:** AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE \_\_\_\_\_

ZYRËS SË PUNËSIMIT \_\_\_\_\_

### FORMULAR – KËRKESË

Për lëshimin e vërtetimit të deklaramit për punësim

#### 1. TË DHËNAT E TË HUAJIT / INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

Z./Znj. \_\_\_\_\_

Mr./Ms. (Emri Mbiemri / Given name(s) Surname)

Lindur më \_\_\_\_\_

Born on (Data Muaji Viti / Day Month Year)

në \_\_\_\_\_

in (Vendlindja / Place and country of birth)

me shtetësi \_\_\_\_\_

Nationality

Me profesion \_\_\_\_\_

Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Type of document and number

Me adresë \_\_\_\_\_

Seat and address



## 2. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT / INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

Për të ushtruar aktivitetin / veprimtarinë e tij/saj: \_\_\_\_\_

Name of the employer

(Emri i Subjektit)

Me adresë: \_\_\_\_\_

Seat and address

Bashkëlidhur me këtë kërkesë gjeni:

- Pasaportë ose dokument identifikimi (kopje), specifiko: \_\_\_\_\_

- Certifikatë familjare, ose dokument që vërteton marrëdhënien familjare, vetëm për anëtarët e familjes së shtetasve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Zonës Shengen që nuk kanë shtetësinë e këtyre vendeve. specifiko \_\_\_\_\_

- Kontratë qiraje (kopje) ose vetëdeklarim për adresën e banimit në territorin e Republikës së Shqipërisë të shtetasit të huaj. specifiko \_\_\_\_\_

- Kontratë pune me punëdhënësin për llogari të të cilit kryen aktivitetin e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë për të punësuarit, ose statusin dhe aktin e themelimit (për shoqëritë) ose vërtetim regjistrimi në QKB (për personat fizikë) për të huajt e vetëpunësuar, ose statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, ku në përmbajtje të rezultojë se investitori bën një investim për investitorët. specifiko \_\_\_\_\_

-----  
Vendi dhe data  
(Place and date)

-----  
Emri / mbiemri i aplikantit  
(Applicant)





## UDHËZIM

Nr. 36, datë 21.9.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN  
NR. 5, DATË 30.1.2006 “PËR TATIMIN MBI  
TË ARDHURAT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 40, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

## UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

**1. Pika 5.7 “Zvogëlimet e kapitalit”  
zëvendësohet me këtë përmbajtje:**

*“5.7 Çdo zvogëlim kapitali, që nuk ka për qëllim zvogëlimin e humbjeve dhe që destinohet për shpërndarje ortakëve, do të konsiderohet dividend dhe do të tatohet si i tillë, por vetëm në masën që zvogëlimi i kapitalit rrjedh nga fitimet e kapitalizuara të shoqërisë dhe jo nga kontributet në para ose në natyrë të pronarëve. Shtesat e kapitalit, kontributet në para ose në natyrë të ortakëve dhe zvogëlimi i kapitalit duhet të jenë në përputhje me rregullat dhe procedurat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.*

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
**Anila Denaj**

## UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 20, datë 14.9.2020

**PËR PROCEDURËN TEKNIKE PËR  
KRYERJEN E PAGESËS NË RASTET E  
KALIMIT TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 105, pika 4, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Drejtësisë

## UDHËZOJNË:

1. Noteri duhet të ketë llogari rrjedhëse të posaçme pranë bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, të dedikuar për kryerjen e transaksioneve financiare në funksion të veprimtarisë noteriale, sipas nenit 68 të ligjit për noterinë. Llogaria e posaçme e noterit mund të shërbejë, kur e kërkojnë palët, edhe në rastet e akteve të tjera noteriale, të cilat nuk kanë për objekt kalimin e pronësisë, por përmbajnë detyrime ndërmjet palëve.

2. Llogaria e posaçme bankare e noterit në bankat e nivelit të dytë është llogari “ESCROW” dhe nuk gjeneron interesa. Ajo është llogari e ndryshme nga llogaria bankare që noteri përdor si person fizik ose si individ.

3. Kur palët paraqiten para noterit për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë të pasurisë së paluajtshme, noteri informon paraprakisht palët për detyrimin ligjor për pagimin e çmimit të pasurisë së paluajtshme, objekt kontrate nëpërmjet llogarisë bankare të posaçme të noterit.

4. Noteri verifikon pronësinë e palës shitëse në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme dhe i bashkëlidh aktit noterial një kopje të përmbajtjes përkatëse të këtij regjistri, të tillë, por jo vetëm, si: leja për kryerjen e transaksionit, kartela e pasurisë së paluajtshme, si dhe harta treguese.

5. Pas hartimit të aktit noterial për kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, noteri kryen veprimet sipas ligjit në fuqi për noterinë. Pas nënshkrimit të aktit noterial nga klientët dhe noteri dhe vulosjes së tij sipas procedurës përkatëse, noteri u kërkon klientëve të paguajnë çmimin e pasurisë së paluajtshme të dakordësuar sipas përcaktimeve në aktin noterial, në llogarinë bankare të posaçme të noterit, duke i pajisur me të dhënat e sakta në lidhje me emërtimin dhe numrin e llogarisë bankare. Për justifikimin e veprimeve bankare të transferimit të vlerës përkatëse, pala paraqet pranë bankës një kopje të aktit noterial të nënshkruar nga palët dhe noteri dhe të vulosur nga ky i fundit, i cili administrohet nga banka.

6. Pala provon pagimin e çmimit të pasurisë së paluajtshme në llogarinë e posaçme bankare të noterit nëpërmjet paraqitjes së dokumentit përkatës bankar.

7. Pas marrjes së dokumentit bankar që provon pagimin e çmimit të kalimit të pasurisë së





paluajtshme në llogarinë e posaçme bankare të noterit, ky i fundit kryen procedurat ligjore për regjistrimin e aktit noterial në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, që administron regjistrin ku ndodhet pasuria e paluajtshme, së bashku me një kopje të dokumentit bankar që konfirmon kryerjen e këtij transaksioni, me qëllim kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme dhe pajisjen me dokumentet e pronësisë në emrin e blerësit.

8. Nëse konstatohet se ka tatim për t'u paguar, me pëlqimin me shkrim të palës shitëse ose sipas specifikimeve në aktin noterial, noteri transferon nga shuma e depozituar në llogarinë e posaçme bankare nga blerësi, vlerën e tatimit të kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin e të ardhurave, në llogarinë bankare të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe paraqet dokumentin bankar që konfirmon kryerjen e transaksionit në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme dhe pajisjen me dokumentet e pronësisë në emër të blerësit.

9. Noteri, brenda 24 orëve nga marrja në dorëzim e certifikatës së pronësisë në emër të blerësit, transferon në llogarinë bankare të shitësit, shumën e depozituar nga blerësi në llogarinë e posaçme bankare, duke zbritur komisionin bankar të aplikuar nga banka për transfertën e kryer, si dhe vlerën e tatimit të kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme nëse pagesa e tatimit është bërë nga noteri.

10. Nëse çmimi i pasurisë së paluajtshme është rënë dakord nga palët që të paguhet me këste, nëse palët nuk kanë kryer specifikime të tjera në aktin noterial, noteri bën transferimin e kështit, brenda 24 orëve nga momenti i plotësimit të kushteve të mëposhtme:

a) noteri ka marrë njoftimin se akti noterial i kalimit të pronësisë është regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës;

b) blerësi ka transferuar kështin në llogarinë e posaçme të noterit.

11. Transferimi i kështit të fundit nga llogaria e posaçme e noterit në llogarinë bankare të palës shitëse, kryhet nga ana e noterit, brenda 24 orëve nga marrja në dorëzim e certifikatës së pronësisë në emër të blerësit.

12. Transferimi i shumës përkatëse nga llogaria e posaçme bankare e noterit në llogarinë e shitësit, bëhet nga noteri në përputhje me rregullat përkatëse bankare.

13. Çdo veprim në lidhje me llogarinë e posaçme bankare duhet të kryhet personalisht nga noteri, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore. Në rast se noteri pezullohet nga detyra, ndërron jetë, arrestohet ose ndaj tij vendoset një masë sigurimi që pamundëson ushtrimin e detyrës, Dhoma Kombëtare e Noterisë cakton me vendim të arsyetuar një noter zëvendësues për të ekzekutuar kontratat e shitjes të ndodhura në proces, në mënyrë që të ketë mundësi të disbursojë shumat e depozituara në llogarinë e noterit pasi të kenë përfunduar procedurat sipas ligjit.

14. Në asnjë rast, noteri nuk mund të kryejë tërheqje nga llogaria e posaçme bankare, por vetëm transferime në llogaritë bankare të palëve, sipas parashikimeve të akteve noteriale të kryera.

15. Për kryerjen e transaksioneve financiare sipas këtij udhëzimi, noteri nuk mund të përdorë llogaritë e tjera në emrin e tij apo të biznesit. Në rast se transferohen në këto llogari, noteri është i detyruar ta kthejë menjëherë transaksionin e kryer në adresën nga kanë ardhur. Çdo veprim tjetër i noterit, në kundërshtim me këtë udhëzim, konsiderohet shkelje e rëndë dhe përbën shkak për procedimin disiplinor, sipas ligjit.

16. Shumat e depozituara në llogarinë e noterit mbahen vetëm për llogari të palëve, për të cilat janë marrë dhe mbahen këto para. Veprimet përmbartimore dhe/ose ato të administratës tatimore qendrore ose vendore, me qëllim ekzekutimin e detyrimeve të noterit kundrejt palëve të treta, nuk mund të shtrihen mbi këtë llogari bankare të posaçme të dedikuar për kryerjen e transaksioneve financiare përkatëse sipas ligjit për noterinë.

17. Udhëzimi i përbashkët nr. 6915/2, datë 30.1.2012, i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave, "Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit", shfuqizohet.

18. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.



Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË  
**Etilda Gjonaj (Saliu)**

MINISTËR I FINANCAVE DHE  
EKONOMISË  
**Anila Denaj**

**VENDIM**  
**Nr. 146, datë 10.9.2020**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“SEKA HYDROPOWER” SHPK, NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et  
“SEKË”, ME KAPACITET TË  
INSTALUAR 12667 kw, DHE “ZAIS”, ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 2295 kw,  
ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR  
14962 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, dhe nenit 15 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nr. 92/2 prot., datë 2.9.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr.101, datë 24.6.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Sekë” me kapacitet të instaluar 12667 kw dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total të instaluar 14962 kw.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/18, datë 26.6.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k..

- Me shkresën nr. 747/1 prot., datë 1.7.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. me shkresën nr. 747/2 prot., datë 20.7.2020, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar.

- ERE, me shkresën nr. 747/3 prot., datë 25.8.2020, iu drejtua sërish shoqërisë duke i sjellë në vëmendje mangësitë e konstatuara, gjatë afatit të shqyrtimit të kësaj kërkesë.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. në përgjigje të ERE-s me shkresën nr. 747/4, datë 27.8.2020, ka përcjellë dokumentacionin plotësues për qëllime të këtij aplikimi.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i nenit 8, të kontratës së koncesionit nr. 7030 rep., nr. 2134 kol., datë 12.6.2013, “Kontratë koncesioni e formës BOT (ndërtim, operim, transferim) për ndërtimin e hidrocentralit Sekë”, të lidhur midis METE (sot MIE) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Hydro – Project” sh.p.k. dhe “Gener 2” sh.p.k. Kjo shoqëri është regjistruar pranë QKB-së në datën 16.9.2013, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”, me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

- Në objekt të veprimtarisë së saj shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. ka: financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e centralit hidroelektrik “Sekë”; prodhimin, transmetimin, shitjen dhe tregtimin e energjisë elektrike të prodhuar dhe transferimin në përfundim të kontratës tek autoriteti kontraktues, në zbatim të kontratës së koncesionit në formën “BOT” (ndërtim, operim, transferim) për ndërtimin e centralit hidroelektrik “Sekë” nr. 7030 rep., nr. 2134 kol., datë 12.6.2013.



- Shoqëria ka depozituar në ERE lejen e ndërtimit nr. 599/2, datë 19.3.2019, lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit për shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k. me objekt: ndërtimin e HEC-it “Sekë” dhe “Zais” në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit në Bashkinë Mat, qarku Dibër dhe Bashkinë Mirditë, qarku Lezhë, sipas vendimit nr. 16, datë 3.10.2018 të Këshillit kombëtar të territorit.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., ka paraqitur në ERE Kontratën e koncesionit të formës BOT me nr. 7030 REP, nr. 2134 KOL, datë 12.06.2013, të lidhur midis METE (sot MIE) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Hydro – Project” sh.p.k. dhe Gener 2 sh.p.k.. Gjithashtu shoqëria ka depozituar në ERE edhe Kontratën shtesë të koncesionit, nr. 2247 REP, nr. 1095 KOL, datë 18.8.2017, të lidhur midis MIE dhe Shoqërisë koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k..

- Shoqëria ka depozituar në ERE miratimin e projektit të zbatimit nga MEI me shkresën nr. 1881/3, prot., datë 26.4.2017, i cili rezultoi të jetë miratimi i projektit të dytë të zbatimit i kryer pas Kontratës së koncesionit me nr. 2247 REP, nr. 1095 KOL, datë 18.8.2017, e cila është bërë pjesë integrale e kontratës bazë të koncesionit.

- Shoqëria ka depozituar në ERE Raportin e Oponencës Teknike nr. 2489 prot., datë 9.3.2016, mbi projektin e zbatimit të HEC-ve “Sekë dhe “Zais” të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., miratuar nga MIE me shkresën nr. 1881/3 prot., datë 26.4.2017. Raporti oponencës teknike konkludon se projekti i zbatimit për ndërtimin e HEC-ve “Sekë dhe “Zais” plotëson kushtet teknike dhe standardet e projektimit.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. ka përcjellë në ERE Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit me nr. 4899 prot., datë 12.9.2017, të lidhur midis saj dhe shoqërisë OST sh.a., për HEC-et “Sekë” dhe “Zais”, të cilët do të lidhen në rrjetin 110 kV të transmetimit nëpërmjet një trakti transformatori 110 kV, në n/stacionin 110/6.3 kV HEC Prellë.

- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujor” me nr. 179 prot., datë 17.9.2018, të miratuar nga KBU Mat, me vendimin nr. 24, datë 12.9.2018, për shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k. me qëllim përdorimin e burimit të ujit të

përroit të Melthit, degë e lumit të Urakës, degë e lumit Mat për HEC-et “Sekë” dhe “Zais”.

- Shoqëria ka depozituar në ERE, deklaratën mjedisore, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 6220 prot., datë 19.7.2018, me nr. 533 identifikim dhe nr. 33 vendimi, për personin juridik “Seka Hydropower” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin ndërtim i HEC-ve ‘Sekë’ dhe ‘Zais’”. Kjo deklaratë mjedisore është lëshuar për kapacitetin total të instaluar të HEC-ve Sekë dhe Zais 14962 kw, me vendndodhje mbi lumin e Urakës dhe përroit të Melthit, Bashkia Mat dhe Mirditë, i cili përkon me kontratën e koncesionit, me kërkesën e shoqërisë dhe me marrëveshjen e lidhjes me rrjetin.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., rezultoi se shoqëria ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. **plotësuar.**

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar.**

- Dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar.**

- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, gjerat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**

- Referuar nenit 4 të kontratës së koncesionit nr. 7030 rep., nr. 2134 kol., datë 12.6.2013, “Kontratë koncesioni e formës BOT (ndërtim, operim, transferim) për ndërtimin e hidrocentralit ‘Sekë’”, fuqia juridike e saj fillon në ditën e nënshkrimit të saj datë 12.6.2013, dhe përfundon në ditën e fundit të përvjetorit të saj. Koha e mbetur për ushtrimin e aktivitetit të licencuar rezultoi 28 vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë



elektrike nga HEC-et: “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw, dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, me kapacitet total 14962 kw, për një afat 28-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
**Nr. 147, datë 10.9.2020**

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN GUSHT 2020**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 10.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve nr. 99/4 prot., datë 3.9.2020 “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, për muajin gusht 2020,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën e saj nr. 7048 prot., datë 31.8.2020, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike për muajin gusht 2020, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bashkëlidhur këtij aplikimi, FSHU sh.a. ka dërguar edhe raportin mbi zhvillimin e procedurës së blerjes së energjisë për muajin gusht 2020.

- FTL sh.a. ka realizuar dy procedura blerjeje të energjisë elektrike, respektivisht për plotësimin e nevojave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a., për periudhën 1.8.2020–31.8.2020.

- Çmimi i blerjes së energjisë elektrike prej 5.505 lekësh/kWh i konvertuar me kursin e këmbimit të datës 29 korrik në të cilën është realizuar procedura e parë e blerjes së energjisë nga FTL sha korrespondon me çmimin mesatar të ponderuar të të dyja procedurave të realizuara nga FTL sh.a. prej 44.44 eurosh/MWh ( $44.44 * 123.88 = 5505$  lekë/MWh ose 5.505 lekë/kWh).

- Sasia prej 74,684 MWh (siç deklaruar në aplikim) është përdorur nga FSHU sh.a. për mbulimin e nevojave të saj, ndërsa diferenca prej 62,956 MWh është përdorur për mbulimin e humbjeve në rrjet të OSSH sh.a.,

- Për përllogaritjen e çmimit mesatar të blerjes së energjisë i referohemi kursit të këmbimit të datës 29 për sasinë prej 43,896 MWh dhe për sasinë e mbetur prej 30,788, kursit të këmbimit të datës 30 korrik sipas publikimeve të Bankës së Shqipërisë.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin nr. 198, datë 12.12.2019, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020”, është 0.75 lekë/kWh.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin nr. 199, datë 12.12.2019, të Bordit të ERE-s “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020”, është 1.5 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë të përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja për muajin gusht 2020, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:



## Çmimi i FMF-së për muajin Gusht 2020

Gusht 2020		Aplikimi FSHU sh.a.	Përlogaritjet e ERE
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Njësia Leke/kWh	Çmimi 5.505
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.17
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	5.67
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50
<b>Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRrTSHt+CA</b>		<b>Leke/kWh</b>	<b>9.71</b>

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionit të përcjellë nga FTL sh.a., si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin gusht 2020, të jetë 9.71 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

## VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes të energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 9.71 lekë/kWh për muajin gusht 2020.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendrike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

## VENDIM

Nr. 148, datë 10.9.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E  
RREGULLORES MBI PROCEDURAT  
PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË  
PËRJASHTIMIT PËR  
INFRASTRUKTURËN E RE TË GAZIT  
NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 32, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 38, nenit 43, pika 1 dhe nenit 78, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 99/3, datë 3.9.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat për dhënie të së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror”,

konstatoi se:

- objektivi i kësaj rregulloreje është të sigurojë nxitjen e investimeve në infrastrukturën kryesore të re, duke garantuar funksionimin e tregut të gazit natyror;

- qëllimi i kësaj rregulloreje është: të përcaktojë rregullat për një procedurë përjashtimi transparente, jodiskriminuese dhe të arsyetuar, në përputhje me rregullat e Paketës së tretë të energjisë;

- procedurat që aplikohen për përjashtimin në këtë draftrregullore, janë bazuar në parashikimet e



nenit 78, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar;

- kjo rregullore paraqet rregulla për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe procedura transparente për të shmangur çdo parregullsi për pasjen e një tregu transparent dhe konkurrues.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat për dhënien e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**

#### VENDIM Nr. 3, datë 18.3.2020

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”, KDZH-ja, e ngritur me urdhër nr. 389, datë 20.11.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, u mblodh më datë 18.9.2020, dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i ish-Arkivit Qendror të PPSH-së,

#### VENDOSI:

1. Deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

- Fondi 302/AP (Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste)

Viti 1956, dosja nr. 5. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1957, dosja nr. 23. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1958, dosjet nr. 27, 27/1, 27/2, 27/3, 27/4. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1959, dosjet nr. 3, 6. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Dosja nr. 34. Niveli i klasifikimit “T.Sekret”.

Viti 1960, dosjet nr. 7, 29. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1961, dosja nr. 2. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1962, dosjet nr. 3, 10, 11. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1963, dosja nr. 15. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1964, dosjet nr. 1, 2, 4, 18, 19, 21, 22. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1965, dosjet nr. 1, 4, 10, 13, 14, 15, 21. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1968, dosjet nr. 5, 5/1. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1969, dosjet nr. 2, 4, 4/1. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1970, dosjet nr. 2, 3, 3/1. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1971, dosjet nr. 4, 6, 9. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1972, dosja nr. 6. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1973, dosja nr. 5. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1974, dosja nr. 2. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1975, dosjet nr. 3, 4, 7. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1977, dosjet nr. 6, 9, 12, 13. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1978, dosja nr. 3. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1979, dosjet nr. 3, 9, 19, 20, 25. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Dosja nr. 26. Niveli i klasifikimit “T. Sekret”. Dosjet nr. 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1980, dosjet nr. 10, 14, 15, 16, 17. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1981, dosjet nr. 2, 16, 17. Niveli i klasifikimit “Sekret”.



Viti 1982, dosja nr. 22. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1983, dosjet nr. 1, 10, 25, 26, 27, 28. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1984, dosjet nr. 12, 18, 20, 21, 22, 23, 24, 28, 29, 30. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1985, dosjet nr. 8, 9, 10, 11, 12, 15, 25, 31, 32, 33. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1986, dosjet nr. 2, 18, 22. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1987, dosjet nr. 16, 23, 24, 26, 30. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1988, dosjet nr. 1, 5. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Viti 1989, dosjet nr. 4, 5, 14, 15. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

2. Dosjet deklasifikohen plotësisht, sepse kanë humbur vlerën dhe qëllimin për të cilin janë klasifikuar, siç përcaktohet në nenin 4, pika “b” e VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017.

3. Ngarkohet sekretari i KDZH-së për zbatimin e këtij vendimi.

4. Një kopje e bibliografisë t’i dërgohet DSIK-ut, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
Ardit Bido

### KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 298, datë 10.9.2020 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për Kuvendin e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 165, datë 15.9.2020, f. 11979 bëhet korigjimi i gabimit material në të gjithë tekstin, për numrin minimal të zgjedhësve, i cili:

**Ishte 200 (dyqind)**

**Bëhet 300 (treqind)**



## KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në kërkesën për shpronësim për interes publik të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5895/8, datë 11.9.2020, ”Për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksioni i rrugës të brendshme të Kalasë së Ali Pashë Tepelenës dhe vazhdimi i shëtittores përgjatë hyrjes së Kalasë së Ali Pashë Tepelenës”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 163, datë 11.9.2020, f. 11944 bëhet korrigjimi i të dhënave të pasurisë në numrin rendor 3, në tabelën bashkëlidhur kërkesës.

## Ishte:

3	Veli	Muharrem	BEGA	3574	12/153	Truall + Biznes	124.26	0	0	0	75.00	1,015	76,125.00	0	26,713	-	124.26	14,209,594.00	14,285,719.00	Ndërtim dykatësh lokal + pikë karburanti
---	------	----------	------	------	--------	-----------------	--------	---	---	---	-------	-------	-----------	---	--------	---	--------	---------------	---------------	--

## Bëhet:

TABELA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT PËR INTERES PUBLIK  
“RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE TË BRENDSHME TË KALASË SË ALI PASHË TEPELENËS DHE VAZHDIMI I SHËTITTORES PËRGJATË HYRJES SË KALASË SË ALI PASHË TEPELENËS

Nr. në tabelën bashkëlidhur kërkesës nr. 5895/8, datë 11.9.2020	Pronaret			Të dhënat (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)			VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË												Shënime ne kartelat e ZVRPP-ja	
	Emër	Atësia	Mbledhri	Zona kadastrale (ZK)	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m <sup>2</sup> )	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"			Ndërtesë banimi (shëtit)			Shpronësim ndërtesë biznes			
								Sipërf. m <sup>2</sup>	Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera në (lekë)	Sipërf. m <sup>2</sup>	Çmimi (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera në (lekë)	Sip. ndërtim Konf. ZVRPP (m <sup>2</sup> )	Çmimi mes shëtitlerjeve sipas ASHK-së (lekë/m <sup>2</sup> )	Vlera e sip. së ndërtimit (lekë)	Sipërf. m <sup>2</sup>	Vlera e situacionit ÇMIMET EKB (lekë)		Vlera totale truall + ndërtesë (lekë)
3	Veli	Muharrem	BEGA	3574	12/153	Truall+Biznes	124.26	0	0	0	75.00	1,015	76,125.00	0	26,713	-	124.26	9,273,381.00	9,349,506.00	Ndërtim Dy-Katësh Lokal+ pikë karburanti









*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë